



Hilfe zur Selbsthilfe

## Kush jemi?

Ne jemi **Help – Hilfe zur Selbsthilfe e.V** Zyra në **Shqipëri**, një organizatë me bazë në Gjermani e cila operon në 28 shtete të botës. Disa nga fushat kryesore ku Help vepron përfshin përfshirjen shoqërore, fuqizimin ekonomik, mbështetjen emergjente, zhvillimin rural dhe ekonominë e gjelbër. Misioni ynë është të përkrahim njerëzit që të ndihmojnë vetveten.

## Na kontaktoni



**Adresa:** Rruga Tish Daija,  
Kompleksi Kika 2, Tiranë

**Tel:** +355 69 572 6762

**Email:** info-alb@help-ev.de

Ky botim është hartuar në kuadër të projektit "COOL Crafting – Krijimi i mundësive dhe lidhjeve optimale midis zejeve tradicionale dhe turizmit në Mirditë" në kuadër të programit EU4Culture, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Help dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS.

[www.eu4culture.al](http://www.eu4culture.al)



## COOL Crafting

*Creating optimal opportunities and links  
between traditional crafts and tourism in Mirdita*



## Çfarë është COOL Crafting?

COOL Crafting është një projekt që ndihmon artizanët e Mirditës të ruajnë dhe zhvillojnë zejët tradicionale. Me fokus në fuqizimin e grave dhe të rinjve, ky projekt lidh kulturën me turizmin, duke sjellë mundësi të reja për punësim dhe zhvillim ekonomik.

## Pse është i veçantë ky projekt ?

• **Ruajtja e traditave:** Ndihmojmë artizanët të mbajnë gjallë mjeshtëritë që kanë kaluar brez pas brezi.

• **Fuqizimi ekonomik:** Përmes artizanatit dhe turizmit, krijojmë mundësi të reja për punësim.

• **Promovimi i Mirditës:** Zejë të tradicionale bëhen pjesë e eksperiencës unike për vizitorët.



## Çfarë përfshin COOL Crafting?

### 1. Trajnime praktike

- ❖ Zhvillimi i aftësive në artizanat dhe marketing.
- ❖ Përshtatja e produkteve për tregje bashkëkohore.

### 2. Aftësim profesional për të rinjtë dhe gratë

- ❖ Mundësi për të mësuar zanate të reja dhe për të hyrë në tregun e punës.

### 3. Promovim i produkteve artizanale

- ❖ Shfaqja e produkteve në evente kulturore dhe panaire.
- ❖ Përdorimi i platformave digjitale për tregtim.

### 4. Rrjetëzim me turizmin

- ❖ Lidhje me operatorë turistikë, hotele dhe dyqane artizanale.
- ❖ Promovim i Mirditës si destinacion kulturor.



## Për kë është COOL Crafting?

- **Artizanët e Mirditës:** Për ata që duan të ruajnë traditën dhe të zgjerojnë mundësitë e tyre.
- **Gratë dhe të rinjtë (18–29 vjeç):** Për ata që kërkojnë aftësi dhe mundësi të reja punësimi.
- **Operatorët turistikë dhe partnerët kulturorë:** Për ata që duan të ofrojnë përvoja autentike për vizitorët.

## Për kë është COOL Crafting?

- **Ndërtoni një të ardhme më të mirë:** Fuqizoni veten dhe komunitetin tuaj.
- **Përrjetësoni trashëgiminë kulturore:** Kthejeni pasionin për artizanatin në një burim të ardhurash.
- **Përmirësoni turizmin lokal:** Jepni vlerë unike Mirditës si destinacion turistik.

## Si të përfshiheni?

- Bashkohuni në trajnimet tona për të zhvilluar dhe promovuar produktet tuaja.
- Merrni pjesë në panairet dhe eventet për promovimin e zejeve.
- Bëhuni pjesë e eksplorimit të mundësive të bashkëpunimit në nivel vendor, kombëtar e më gjerë.